



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2154/3 Prot.

Vlorë më, 29.07.2026

VENDIM

Nr. 39, datë 29.07.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE
INFRASTRUKTURE SI DHE KUOTATAT E PRANIMIT NË PROGRAMIN E
STUDIMIT "DOKTORATË" NË "STUDIME GJUHËSORE, LETRARE E
KULTURORE"**

Mbështetur në nenin 79 në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kreun I, pika 3 në VKM-në nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor", e ndryshuar, VKM-në nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, nenin 63, pika 3 në Statutin e UV-së, nenin 6 në Rregulloren e programit të studimit, si dhe në përmbushje të detyrimeve për certifikimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike në funksion të programit të studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore", sipas kreut IV/F, pika 1, gërma a në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, referuar vendimit të Senatit Akademik nr. 10, datë 06.03.2024 "Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit për vitin akademik 2026-2027, bazuar në shkresën me nr.576/1 prot., datë 17.07.2026 të Fakultetit të Shkencave Humane "Për përcaktimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike në funksion të programit të studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore"; relacionit të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, përcjellë me shkresën nr. 2083/1 prot., datë 27.07.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.07.2026,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë numrin 10 (dhjetë) si numrin maksimal të kapaciteteve (akademike dhe infrastrukturore) pritëse për programin e studimit.
2. Numri i kuotave të pranimit i propozuar për vitin akademik 2026-2027 është 9 (nëntë) nga të cilat 7 (shtatë) brenda vendit dhe 2 (dy) nga trojet.
3. Numri i projekteve në funksion të programit është 9 (nëntë) për vitin akademik 2026-2027, si më poshtë:
 - a) "Mësimdhënia e gjuhës së huaj në dhe për kontekste evropiane";



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- b) "Integrimi dhe shfrytëzimi i programeve kompjuterike dhe korpusit gjuhësor në kurrikulat pasuniversitare dhe në hulumtimet shkencore në fushën e albanologjisë";
 - c) "Onomastika e Lumit të Vlorës, trashëgimi arkeologjike gjuhësore shqiptare"
 - d) "Advancing Quality Higher Education in Eastern Balkans through Facilitating AI Integration in Teaching, Learning and Research"
 - e) "Strengthening Capacities for the Implementation of Dual Education in Albanian Higher Education"
 - f) "Harvesting (Digital) Alternation in Days That Knock-down Inaccessibility – HAËKING"
 - g) "Aspekte gjuhësore dhe juridike për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve"
 - h) "Efikasiteti i përdorimit të teknologjisë digjitale në përkthimin e terminologjisë teknike në Universitetin e Vlorës"
 - i) "Ndërgjegjësimi mjedisor përmes reflektimit personal dhe artikulimit gjuhësor: një studim pilot në arsimin e lartë"
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përcillet së bashku me dokumentacionin plotësues të cilësuar në kreun **IV/F** në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor.
6. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliq

